



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 43

Prishtinë, më 9.11.2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Fidan Rekalju, Abdyl Salihu, Arbërie Nagavci, Mufera Shinik dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Munguan: Valentina Bunjaku-Rexhepi, Driton Çaushi, Nezir Çoçaj dhe Verica Çeraniq.

Pjesëmarrës të tjerë: Florim Kryeziu e Mehdi Uka – MKRS, përfaqësues të KDI dhe mediave.

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky :

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.10.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive;**
- 6. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.10.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 22.10.2018 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sport i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sport

Ismajl Kurteshi i njoftoi anëtarët e komisionit se leximi i parë i Projektligjit nr. 06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sport, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sport, është bërë në seancën plenare të datës 2.11.2018, ku është ngarkuar komisioni për shqyrtimin e mëtejme dhe amendamentim.

Qëllimi i këtij Projektligji është harmonizimi i gjobave dhe sanksioneve kundërvajtëse me Ligjin nr. 05/L – 087 për Kundërvajtjet dhe krijimi i kushteve për zbatimin efikas të sistemit të sanksioneve kundërvajtës në fushën e sportit.

Ai tha se në parim është kundër zvogëlimit të gjobave për kundërvajtje siç paraparë nga Qeveria.

Arbërie Nagavci tha se është kundër propozimit të Qeverisë që ka të bëjë me uljen e gjobave për kundërvajtje në sport për profesionistët që detyrojnë sportistët të stërviten apo të marrin pjesë në gara kur nuk janë të aftë apo kanë ndonjë lëndim. Andaj nuk mund të votoj diçka që është në dëm të shëndetit të sportistëve.

Teuta Haxhiu tha se qëllimi i këtyre projektligjeve ka të bëjë me harmonizimin e gjobave me Ligjin për kundërvajtje, andaj i përkrah ndryshimin dhe plotësimin e projektligjeve.

Albulena Balaj-Halimaj tha se nuk e kupton dallimin mes veprës penale dhe kundërvajtje duke pasur parasysh se detyrimi i sportistëve nga personi profesionist për të marrë pjesë në gara apo stërvitje siç parashihet në nenin 77 mund të konsiderohet si vepër penale, e jo siç është paraparë si kundërvajtje.

Anëtarët e komisionit shqyrtuan projektligjin nen për nen dhe u propozuan amendamentet si vijon:

Amendamenti 1

Titulli i projektligjit ndryshohet si vijon:

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2003/24 PËR SPORT I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 04/L-075

Amendamenti 2

Neni 1, ndryshohet si vijon:

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr.2003/24 për Sport.

Amendamenti 3

Neni 3, ndryshohet si vijon:

Neni 3

1. Neni 78 i ligjit bazik, paragrafi 1 ndryshohet, si vijon:

Neni 78

78.1. Me dënim me gjobë, prej 500 (pesëqind) euro deri 2 000 (dymijë) euro, dënohet personi i cili jep ose merr preparate stimuluese të cilat janë të ndaluara dhe të dëmshme për shëndet. Personat e tillë dënohen edhe me ndalimin e ushtrimit të profesionit për kohë të caktuar prej 1 (një) deri në 3 (tre) vjet.

2. Neni 78 i ligjit bazik, paragrafi 2 fshihet.

Komisioni me 4 (katër) vota për, 2 (dy) vota kundër dhe 1 (një) votë abstenim miratoi amendamentet e propozuara në Projektligjin nr.06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport, dhe raportin me amendamente e procedon te komisionet e përhershme.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

Ismajl Kurteshi tha se leximi i parë i Projektligjit nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit është bërë në seancën plenare të datës 2.11.2018, ku është ngarkuar komisioni për shqyrtimin dhe amendamentim.

Qëllimi i këtij Projektligji është harmonizimi i gjobave dhe sanksioneve kundërvajtëse me Ligjin nr.05/L-087 për Kundërvajtjet dhe krijimi i kushteve për zbatimin efikas të sistemit të sanksioneve kundërvajtës në fushën e sponsorizimeve.

Anëtarët e Komisionit shqyrtuan projektligjin nen për nen dhe u propozua amendamenti si vijon:

Amendament 1

Neni 1 ndryshohet si vijon:

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit 05/L-090 për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Komisioni me 4 (katër) vota për, 2(dy) vota kundër dhe 1 (një) votë abstenim miratoi amendamentin e propozuar në Projektligjit nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit

nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, dhe raportin me amendamente e procedon te komisionet e përhershme.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive

Ismajl Kurteshi tha se leximi i parë i Projektligjit nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive është bërë në seancën plenare të datës 2.11.2018, ku është ngarkuar komisioni për shqyrtimin dhe amendamentim.

Qëllimi i këtij Projektligji është harmonizimi i gjobave dhe sanksioneve kundërvajtëse me Ligjin nr.05/L – 087 për Kundërvajtjet dhe krijimi i kushteve për zbatimin efikas të sistemit të sanksioneve kundërvajtës në kuadër të parandalimit dhe sanksionimit të dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive.

Anëtarët e komisionit shqyrtuan projektligjin nen për nen dhe u propozuan amendamentet si vijon:

Amendamenti 1

Neni 1 ndryshohet si vijon:

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive.

Amendamenti 2

Neni 3 ndryshohet si vijon:

Neni 3

Neni 17 i ligjit bazik, ndryshohet si vijon:

Neni 17

Dënimet për personat fizikë

Për veprimet e kryera të cilat janë paraparë me nenin 4 të këtij ligji personi fizik dënohet me gjobë prej 200 (dyqind) euro deri në 2.000 (dymijë) euro.

Komisioni me 4 (katër) vota për, 2 (dy) vota kundër dhe 1 (një) votë abstenim miratoi amendamentet e propozuar në Projektligjin nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, dhe raportin me amendamente e procedon te komisionet e përhershme.

6. Të ndryshme.

Albulena Balaj -Halimaj, i njoftoi anëtarët e komisioni lidhur me kërkesën e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prizren që ka të bëjë me lejimin e rritjes së numrit të mësimdhënësve në Komunën e Prizrenit dhe mosshfrytëzimit të grantit specifik për arsimin parauniversitar.

Ismajl Kurteshi, lidhur me këtë shkresë, kërkoi që e njëjta t' iu dërgohet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Administratës Publike dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për të shqyrtuar kërkesën e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prizren.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi